

Kosovë

Mbrojtja e të drejtave të njeriut mbetet e dobët në Kosovë. Pavarësisht reformave, sistemi i drejtësisë vazhdon të ketë mangësi të mëdha. Komunitetet e pakicave etnike Rome, Ashkali dhe Egjiptiane në veçanti, vazhdojnë të vuajnë diskriminim. Gazetarët dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut janë sulmuar dhe kërcënuar gjatë vitit 2013.

Disa herë kanë shpërthyer tensione në Veriun e ndarë, edhe pse marrëdhëniet politike me Serbinë janë përmirësuar, siç tregoi një marrëveshje e arritur në Prill 2013, që përcaktoi krijimin e një komandoje policie speciale dhe një gjykate apeli për pakicën serbe; një marrëveshje e nënshkruar në Gusht përcakton kalimin e vazhdueshëm të kufirit mes Kosovës dhe Serbisë në 2014; si dhe shpërbërja e strukturave paralele serbe në Veri të Kosovës. Në Shtator, persona të paidentifikuar vranë një oficer policie të Misionit EULEX, gjatë një sulmi kundër dy automjeteve të EULEX. Gjatë hartimit të këtij raporti, policia ishte ende duke hetuar çështjen.

Dënueshmëria, përgjegjësia, aksesimi në gjyqësi

Reforma e sistemit të drejtësisë e zbatuar në Janar, ristrukturoi gjykatat në përpjekje për të zgjidhur çështjet e akumuluar prej vitesh ende në proces. Gjithashtu, një kod i ri penal hyri në fuqi po në Janar, pa tre nenet që rrezikonin të kufizonin lirinë e medias.

Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2013, gjykatësit e EULEX-it morën përsipër pesë gjykime për krime lufte, duke provuar pafajsinë e të akuzuarve në të gjitha rastet, me përjashtim të njërit. Pafajësia e Fatmir Limajt dhe nëntë personave të tjerë, lidhur me vrasjen masive të civilëve serbë dhe shqiptarë në vitin 1998 në Kleçkë, nga ana e forcave të UÇK-së, tregon dobësitë e programit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë dhe sfidat për hetimin e krimeve të kryera gjatë dhe pas luftës. Dëshmia e dhënë nga një dëshmitar kyç, i gjetur i vdekur në një park në Gjermani në Dhjetor 2012, rast të cilin policia e quajti vetëvrasje, u cilësua fillimisht si e papranueshme dhe në rigjykim si kontradiktore dhe e pabesueshme.

Në Qershor, tre persona u dënuan me gjashtë, katër dhe tre vite përkatësisht, për rrahje dhe torturim civilësh shqiptarë nga Kosova, të mbajtur ilegalisht në qendrën e burgimit ndërmjet 1998 dhe 1999. Në Tetor, prokurori special i EULEX akuzoi 15 persona për krime lufte ndaj civilëve dhe të burgosurve në 1998 në një qendër burgimi në Likovaç.

Qindra çështje kanë mbetur pezull ose janë ende në shqyrtim pranë Prokurorisë Speciale të Kosovës, Njësisë hetuese për Krime Lufte të Policisë së Kosovës, dhe EULEX. Gjatë hartimit të këtij raporti, rezultojnë pezull 13 mandate arresti ndaj Serbëve që besohet se jetojnë jashtë Kosovës. Eulex vazhdon të hetojë 94 çështje për krime lufte gjatë periudhës 1998 – 1999 së luftës në Kosovë, duke përfshirë masakra në Mejë, Dubravë, dhe Krushë, ku mendohet se janë përfshirë më shumë se 1 000 viktima.

Në fund të Gushtit, Human Rights Review Panel (HRRP), një organizëm i pavarur i krijuar në 2009 për të ekzaminuar raportimet e dhunimit të të drejtave të njeriut nga stafi i EULEX-it, mori 15 vendime, duke identifikuar dhunime në 5 raste. Në rastin lidhur me sulmet nga ana e policisë së Kosovës dhe shqiptarëve etnikë kundër serbëve gjatë festës fetare të Vidovdanit gjatë 2012, HRRP arriti në përfundimin se EULEX ka dështuar në gjetjen e burimeve të përshtatshme për të siguruar mbrojtje apo për të drejtuar një hetim efektiv të raportimeve të abuzimit me të drejtat e njeriut.

Liria e medias

Gazetarët vazhdojnë të përballen me një mjedis të pafavorshëm. Në Maj, një bombë gazi u hodh pranë banesës të kryeredaktorit të Radiotelevizionit të Kosovës, televizion publik, duke shkaktuar dëme, por jo të lënduar. Autoritetet e Kosovës dënuan sulmin dhe policia filloi hetimet. Gjatë hartimit të këtij teksti, nuk është ndërmarrë ende asnjë arrestim.

Në Qershor një panel i përbërë nga gjykatës të EULEX-it dhe të Kosovës shpallën të pafajshëm ish-kryetarin e bashkisë së Skënderajt Sami Lushtaku, ish- pronarin e Infopress, Rexhep Hoti; ish-kryeredaktorin e Infopress Avni Azemi; si edhe dy gazetarë të tjerë të akuzuar për kërcënime ndaj Jeta Xharrës, drejtoreshë e BIRN-it, një media rajonale. Gjykata vendosi se 12 lajmet, në të cilat Infopress i referohej Xharrës si “spiune serbe” apo “lavire ambasade” në përgjigje të një transmetimi të BIRN TV në lidhje me shpërdorimet e detyrës

në Skënderaj, gjatë kohës kur Lushtaku ishte kryetar bashkie, nuk përbëjnë kërcënim për Xharrën.

Trajtimi i pakicave

Pakicat rome, ashkali dhe egjiptiane, që arrijnë në rreth 40 000 persona, janë ndër grupet më të prekura dhe të marginalizuara në Kosovë. Ata vazhdojnë të përballen me vështirësi në pajisjen me dokumenta, duke përjetuar pengesa në aksesin ndaj shërbimet shëndetësore, asistencës sociale dhe arsimit.

Në Korrik, Ministria e Mirëqënies Sociale ndryshoi kriteret e përfitimit të asistencës sociale, në mënyrë të tillë që pengon realisht shumë individë romë, ashkalinj dhe egjiptianë të përfitojnë shërbime sociale. Strategjia e integritit të romëve, ashkalinjve, dhe egjiptianëve e vitit 2010, vazhdon të ekzistojë vetëm në letër dhe qeveria nuk ka arritur të caktojë fondet e duhura për të zbatuar strategjinë.

Ndërsa janë marrë masa në kuadrin e Strategjisë së ri-integrimit të personave të riatdhesuar, duke përfshirë romët, ashkalinjtë, dhe egjiptianët, pasi fonde të caktuara qeveritare u transferuan nga Ministria e Punëve të brendshme tek zyrat lokale për Komunitetet dhe Kthimin, me përgjegjësi për identifikimin dhe përkrahjen e të kthyerëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë. Lidhur me impaktin e transferimit të këtij fondi, është shumë herët të vlerësohet në momentin e hartimit të këtij raporti.

Tensionet mes pakicës serbe dhe shumicës shqiptare u përshkallëzuan gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, veçanërisht në Veriun e Kosovës, me një sulm fatal ndaj një oficeri të EULEX-it në Shtator dhe kërcënime ndaj një politikani serb dhe familjes së tij në Mitrovicë, përpara zgjedhjeve lokale në Nëntor. Organet e policisë ishin duke hetuar të dyja këto incidente gjatë momentit të hartimit të këtij raporti. Në kundërshtim me vendimet e Gjykatës kushtetuese dhe në kundërshtim me autoritetet e zbatimit të ligjit, Kuvendi i Kosovës aprovoi një amnesti për disa krime të kryera deri në Qershor 2013, , që përfshijnë shkatërrimin e pasurisë, përkrahjen e keqbërësve pas kryerjes së krimin dhe falsifikimin e dokumenteve. Përkrahësit e ligjit të amnistisë, argumentojnë se qëllimi i tij është të lehtësojë integrimin e pakicës serbe në Kosovë.

Mes Janarit dhe Gushtit, shërbimet policore kosovare raportuan vetëm 10 incidente ndër-etnike, pa përcaktuar nëse këto incidente përfshinin të lënduar fizikisht apo dëme në pronë. Vrojtuesit ndërkombëtarë mbeten të shqetësuar nga fakti se shumë incidente ndër-etnike nuk raportohen, nuk regjistrohen ose klasifikohen gabimisht.

Në Janar, rreth gjashtëdhjetë varre në katër varreza ortodokse u vandalizuan në zonën e pakicës serbe në Kilokot, Kastriot, Prizren, dhe Fushë Kosovë. Policia arrestoi 5 persona në Janar, duke përfshirë 4 persona nën 18 vjeç. Kryeministri Hashim Thaci dënoi aktin vandal, dhe caktoi 97 000 Euro (131 000 USD) për të riparuar varret. Në Shkurt, dy fëmijë serbë u plagosën kur një person i panjohur hodhi një granatë në një banesë, akt ky i dyshuar si dhunë etnike. Politika ishte duke hetuar rastin në momentin e hartimit të këtij teksti.

Mbrojtësit e të drejtave të njeriut

Në Mars, të paktën dy persona rrahën brutalisht mbrojtësen e të drejtave të njeriut Nazlie Bala, pranë banesës të saj. Më parë ajo kishte marrë kërcënime për vdekje, duke iu referuar përkrahjes publike nga ana e saj, të një amendamenti të propozuar për një ligj ekzistues, i cili do të siguronte kompensim dhe rehabilitim për të mbijetuarit e krimeve të luftës nga dhuna seksuale. Në një letër gjetur poshtë derës së apartamentit shkruhej: “Mos mbro turpin. Përndryshe do të të vrasim.” Policia është ende duke hetuar çështjen në momentin e shkrimit të këtij teksti.

Një grup prej rreth 20 personash të armatosur me leva, shkatërruan pajisjet dhe rrahën një të punësuar, gjatë lançimit të numrit mbi seksualitetin të revistës “Kosovo 2.0” në Dhjetor 2012. Numri në fjalë përmbante artikuj të ndryshëm lidhur me çështjet e komunitetit LGBT. Në Shtator misioni i EULEX dhe prokurori i Kosovës akuzuan tre persona për dhunim fizik dhe nxitje të urrejtjes.

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor

Personat LGBT në Kosovë, përballen me stigmatizim social dhe me kulturën e heshtjes. “Qesh”, e vetmja organizatë LGBT në Kosovë, raportoi marrjen e kërcënimeve të ndryshme nëpërmjet mediave sociale në lidhje me një event LGBT të mbajtur në Maj, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë. Organizata raportoi një nga këto kërcënime dhe policia ishte duke hetuar në momentin e shkrimit të këtij teksti.

Azilkërkuesit dhe personat e shpërngulur

Gjatë tetë muajve të parë të vitit, Zyra e Komisionerit për refugjatët pranë Kombeve të Bashkuara (UNHCR) regjistroi 483 kthime të vullnetshme, duke përfshirë persona nga jashtë Kosovës dhe persona të shpërngulur brenda Kosovës, krahasuar me 589 të kthyer në të njëjtën periudhë në 2012.

Kthimet në Kosovë nga Europa Perëndimore vazhduan, me një asistencë të kufizuar pas kthimit. Mes Janarit dhe Gushtit, UNHCR regjistroi 2 149 kthime të detyruara në Kosovë, duke përfshirë 378 romë, 143 ashkalinj, dhe 6 egjiptianë. Shumica e anëtarëve të pakicave u kthyen nga Suedia (243) dhe Gjermania (150).

Kampi Osterode, i kontaminuar me plumb, jashtë Mitrovicës u mbyll në Dhjetor 2012 dhe pesë familjet e mbetura romë ashkali dhe egjiptiane u vendosën në një ndërtesë apartamentesh në Mitrovicën e Veriut.

Aktorët kyç ndërkombëtarë

Në një rezolutë të adoptuar në Janar, Parlamenti dhe Këshilli i Europës i bënë thirrje autoriteteve kosovare të luftojnë korrupsionin, të ndërmarrin reformat gjyqësore, të shqyrtojnë krimet e luftës, të mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, të sigurojnë pavarësinë e mediave dhe mbrojtjen e duhur të gazetarëve, të forcojnë luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Si edhe i kërkoi Bashkimit European, të përqëndrojë politikën e dialogut me Kosovën në përforsimin e zbatimit të ligjit.

Përfaqësuesi i lartë i BE-së për punët e jashtme, Catherine Ashton, mirëpriti marrëveshjen e Prillit me Serbinë, e cila synon normalizimin e marrëdhënieve dhe përparimin e integritetit evropian, por dështoi në theksimin e rëndësisë së forcimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në Tetor, gjatë progresraportit, një marrëveshje stabilizimi midis BE dhe Kosovës, Komisioni European ngriti shqetësime serioze në lidhje me zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e pakicave në Kosovë. Komisioni European i kërkoi autoriteteve kosovare që të përballen me korrupsionin, krimin e organizuar, dhe sulmet ndaj gjyqësorit, duke forcuar legjislacionin

dhe zbatimin e tij dhe përmes parashikimit të masave të sigurisë dhe mbrojtjes për gjykatësit, prokurorët, dëshmitarët dhe paditësit. Gjithashtu, u kërkoi autoriteteve të marrin masa të mëtejshme për të reduktuar çështjet e tejzgjatura gjyqësore duke forcuar zbatimin e vendimeve të gjyqësorit. Raporti u bënte thirrje autoriteteve të hetojnë sulmet me shkaqe etnike apo fetare, si edhe zbatimin e menjëhershëm të strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane.

Gjatë një vizite në Qershor, Komisioneri i OKB për të drejtat e njeriut, Navi Pillay shprehu shqetësim serioz në lidhje me zbatimin e ligjit, duke përfshirë pavarësinë e gjyqësorit dhe zvarritjen e çështjeve, si edhe diskriminimin e romëve, ashkalinjve, egjiptianëve, serbëve, goranëve dhe pakicave të tjera, dhe bëri thirrje për zbatim strikt të ligjeve dhe për një reagim më të ashpër ndaj diskursit të urrejtjes dhe jotolerancës etnike.

Në Korrik, sekretari i përgjithshëm i OKB - së, Ban Ki-moon i bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë të bashkëpunojnë për të zgjidhur çështjen e personave të humbur në Kosovë. Deri më sot më shumë se 1 700 persona mbeten të humbur si pasojë e luftës me Serbinë.